

**VENDIM**  
**Nr. 931, datë 18.11.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “A”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, çregjistrohet individ i renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkë-punëtorë apo financues për talibanët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË**  
**TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

**A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBA-NËT**

a) Lista e ndryshuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”**:

1. TOREK; AGHA.